



POSTER

Sesion informues nga KODE Labs

Përshkrim i shkurtër i Programit të Punës Praktike / KODE Labs

Në qoftë se keni njohuri ose jeni të interesuar në fushën e Ndërtesave të Mençura (Smart Buildings) dhe keni dëshirë të punoni në projekte mbarëbotërore, atëhere ju mirëpresim t'i bashkangjiteni kësaj mundësie për punë praktike në Inxhinieri të Ndërtesave të Mençura.

Për 6 muaj, ju do të keni mundësinë të përfitoni nga eksperiencia praktike me platformën tonë KODE OS, do të zgjeroni njohuritë tuaja rreth industrisë së ndërtesave inteligjente, sistemeve HVAC, IoT dhe sistemeve të tjera të ndërtesave. Gjithashtu, ju do të keni mundësinë të punoni me klientët tanë global, si Empire State, Ford, Visa, Hines, për të përmendur vetëm disa, direkt nga zyra jonë në Prishtinë.

Kjo praktikë me pagesë dhe orar të plotë do të ju ofrojë një mundësi unike për të fituar përvojë praktike të inxhinierisë në një mjedis pune dinamik dhe inovativ, ku një ditë mund të jeni edhe ju pjesë e këtij ekipi.

Mos e humbisni sesionin tonë informativ këtë të martë (**16 janar**), për të kuptuar më shumë rreth kompanisë tonë, detajeve të kësaj pune praktike dhe për të shtruar pyetje të cilat mund ti keni në lidhje me programin.



Kush mund të aplikoj ?

- Studentët të cilët kanë interes dhe dëshirë për të mësuar rreth industrisë së ndërtesave të mençura, HVAC dhe IoT.
- Studentët të cilët dëshirojnë të sfidojnë veten në një ambient dinamik për 6 muaj dhe me orar të plotë.
- Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike
 - Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment;
 - Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtëritshme;
 - Dizajn inxhinierik dhe Automjete;
 - Komunikacion dhe transport dhe
 - Mekatronikë.

*Jemi të hapur dhe për studentë të drejtimeve tjera, të cilët shprehin interes për t'u bërë pjesë e programit.

Apliko tani:



Afati për aplikim:

Aplikimi do të jetë i hapur deri më 21 Janar, 2024.

**Më shumë informata:
web: kodelabs.com**